

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË**

Zgjidhjet

**P4**

Nr.

**FLETË PROVIMI**  
Exam Paper

**Udhëzime/Instructions:**

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ  
MBIKËQYRËSIT  
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA  
PYETJEVE  
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË  
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË  
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.  
Your name should appear nowhere in this test.

Data 20.02.2021

## CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</b>
<b>A. Zgjidhje shumëfishe</b>	<b>20</b>	
<b>B. Zgjidhje opcionale</b>	<b>20</b>	
<b>1. Problemi 1</b>	<b>15</b>	
<b>2. Problemi 2</b>	<b>20</b>	
<b>3. Problemi 3</b>	<b>7</b>	
<b>4. Problemi 4</b>	<b>5</b>	
<b>5. Problemi 5</b>	<b>5</b>	
<b>6. Problemi 6</b>	<b>8</b>	
<b>Total</b>	<b>100</b>	

**Pjesa A. Detyra me zgjidhje të shumëfishtë (vëtëm një opcion i saktë) Nga 2 pikë secila**

1. Fature në vlerë prej 770.00 Euro (përfshirë Tvsh) që është kalkuluar gabimisht me Tvsh prej 16% duhet te korigjohet me normën standarde. Në të njëjtën ditë është kthyer edhe një pjesë e mallit në këtë faturë i cili kthim poashtu duhet rregulluar ne faturë. Malli i kthyer ka pasur kosto 120.00 Euro. Sa duhet të jetë vlera e faturës përfshirë Tvsh me norme standarde 18% pas korigjimit?
  - a) 650.00 Euro;
  - b) 641.67 Euro;**
  - c) 767.10 Euro;
  - d) 783.27 Euro.
2. Enis Gashi në muajin Dhjetor 2020 ka pasur pagën Bruto (primare) prej 770.00 Euro. Në Dhjetor të vitit 2020, menaxhmenti i kompanise ku ai është i punësuar vendosi që paga e Enisit të rritet për Neto vlerë prej 50.00 Euro. Sa do të jetë paga NETO në Janar të vitit 2021 për Enisin?
  - a) 723.30 Euro;
  - b) 730.55 Euro;**
  - c) 820.00 Euro;
  - d) 874.62 Euro.
3. Biznesi "SMART", person i tatueshëm, me seli në Kosovë ofron shërbime marketingu (të reklamimit të produkteve) **në Kosovë**, në vlerë të tatueshme prej 600.00 Euro për kompaninë "SWISS" që e ka selinë në Zvicër. Për këtë shërbim, komapnia kosovare duhet të lëshojë faturën në total:
  - a) 708.00 Euro;**
  - b) 600.00 Euro;
  - c) 508.47 Euro
  - d) 600.00 Euro me Ngarkesë të kundërt;
  - e) Asnjëra më lartë.
4. Kompania "DISCOUNT" shpk, kryen furnizime të tatueshme për të gjitha produktet që shet. Një klienti afarist i ka lëshuar faturën në vlerë prej 12,380.00 (pa e përfshirë Tvsh) dhe i ka ofruar një zbritje/lirim tregtare prej 18% mbi këtë shumë. Sa do të jetë vlera totale e faturës pas zbritjes duke përfshirë edhe Tvsh me normë standarde prej 18% për furnizimin e bërë?

- a) 12,380.00 Euro;
  - b) 10,151.60 Euro;
  - c) 11,978.89 Euro;
  - d) 14,680.40 Euro;
5. Kompania "FSH" O.P është biznes i cili tatohet sipas skemës reale dhe përbëhet nga 2 ortakë (Fatime dhe Shaipi) pra biznes ortakëri. Sipas legjislacionit tatimor ortakëria dhe ortakët me 31.12.2020 duhet të deklarojnë pranë ATK-se:
- a) Ortakëria deklaratën DO ndërsa ortakët se bashku një deklaratë të PD-së;
  - b) Ortakëria deklaron PD ndërsa ortakët secili DO;
  - c) Ortakëria deklaron DO ndërsa secili ortak deklaratën e PD-së.
  - d) Ortakëria deklaron CD ndërsa ortakët secili deklaratën DO.
6. Kompania ABC, i cili është biznes tregtar dhe i regjistruar në TAK dhe TVSH deshiron të përfundoj veprimtarinë ekonomike. Si duhet të trajtohen stoqet të pashitura (për të cilat është zbritur TVSH) të cilat mbesin në fund, çregjistrimi i biznesit do të bëhet me datë 30 qershor 2020?
- a) Stoqet do të fshihen nga librat;
  - b) Paraqiten si furnizime në periudhën e fundit ;
  - c) Pas mbylljes mund të shiten pa faturë;
  - d) Trajtohen si humbje për qëllime TAK.
7. Cilat nga dokumentet burimore duhet të paraqitet në baza mujore në librat e blerjes dhe shitjes së një kompanie:
- a) Faturat blerëse dhe faturat shitëse;
  - b) Notat kreditore/debitore dhe urdhëresat financiare;
  - c) Kthimet e mallit të shitur/blerë dhe ekstraktet bankare;
  - d) Të gjitha më lartë;
8. Qiradhënësi, një biznes tregtar, lëshon faturën për një pasuri në baza mujore qiramarrësit "BOOKS" shpk. Vlera e faturës është 800.00 plus Tvsh (944.00). Sa duhet të **ndalë tatim në burim për qira**, qiramarrësi "BOOKS" shpk për këtë faturë Qiradhënësit. Fatura është subjekt i tatimit të qirasë sipas normës së aplikueshme të ligjit në Kosovë.

- a) 44.00 Euro;
  - b) 59.04 Euro;
  - c) 66.06 Euro;
  - d) 72.00 Euro
9. Biznesi MEKANIKU shpk veprimtaria afariste e të cilit është mirëmbajtja e automjetëve, e cila për qëllime tatimore është biznes i regjistruar si Korporatë e Vogël me Tvsh, si duhet të deklarojë tatimin e të hyrave nga mirëmbajtja në baza tremujore ky biznes?
- a) Shërbyese me 9%;
  - b) Tregtare me 3%;
  - c) Shërbyese dhe tregtare me 10%;
  - d) Asnjëra më lartë.
10. Shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore përcaktohet duke aplikuar përqindjet e mëposhtme në mënyrë individuale të pronës së prekshme individuale sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore dhe atë sipas kategorisë si cilës i përkasin asetet përkatëse. Cila nga të mëposhtmet është e saktë?
- a) Kategoria 1: njëzet për qind (20%);
  - b) Kategoria 2: pesëmbëdhjetë për qind (15%)
  - c) Kategoria 3: dhjetë për qind (10%) dhe
  - d) Kategoria 4: pesë për qind (5%);

1. Sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për aktivitete ekonomike të tatimpaguesit do të kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periudhën e kohëzgjatjes së qirasë.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas Ligjit të Tvsh një biznes me rastin e përllogaritjes së pragut për regjistrim në Tvsh (përveç regjistrimit vullnetar), personi duhet të marrë parasysh shumën totale të të gjitha furnizimeve të tija përgjatë periudhës së 12 muajve të fundit dhe kjo shume të jetë mbi 30,000 Euro.

E saktë

E pasaktë

3. Furnizim i barnave do të jetë i liruar nga ngarkesa me Tvsh.

E saktë

E pasaktë

4. Sipas ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, të ardhurat e përfituara nga grandet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit nuk janë të ardhura të tatueshme.

E saktë

E pasaktë

5. Bazuar në ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, kërkesa për kreditim ose rimbursimi për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloji të tatimit mund të dorëzohet brenda pesë (5) vitesh nga data kur është paguar tatimi.

E saktë

E pasaktë

6. Bazuar në Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një tatimpagues mundet të dorëzojë një ndryshim deklarate tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar tashmë. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se pesë (5) vjet pas datës obligative kur deklarata është dorëzuar fillimisht.

E saktë

E pasaktë

7. Zyra e Regjistrimit duhet të ruajë përherë të gjitha shënimet dhe dokumentet, duke përfshirë dokumentet e pranuar ose të regjistruara.

E saktë

E pasaktë

8. Sipas ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, shpenzimet për qiratë e banesave, të cilat shërbejnë për akomodimin dhe fjetjen e punonjësve rezident dhe jo rezident, pavarësisht nga kushtet e kontratës së punësimit apo shërbimit nuk janë shpenzime të lejueshme.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas ligjit nr. 06/L-032 për "Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", raporti i auditimit nënshkruhet nga auditori ligjor, ku firmoset edhe data e nënshkrimit; kur një firmë auditimi kryen auditimin, raporti i auditimit nuk nënshkruhet nga auditori ligjor që kryen auditimin në emër të firmës së auditimit;

E saktë

E pasaktë

10. Sipas Ligjit "Për Shoqëri Tregtare", shoqëria e regjistruar tregtare ose shoqëria e huaj tregtare, por jo ndërmarrja individuale nuk mund të shfrytëzojnë një emër tjetër tregtar i cili është i ndryshëm nga emri i regjistruar zyrtar.

E saktë

E pasaktë

11. Sipas Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në rastet kur tatimpaguesit paraqesin në ATK, kërkesë për pagesë të tatimit me marrëveshje me këste, interesi nuk do të rrjedh nga muaji që pason muajin në të cilin marrëveshja është vendosur deri sa është respektuar tërësisht.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, pagesa e kontributeve është e detyrueshme për të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe të punësuarit e huaj deri në moshën e pensionimit.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit të TVSH-së, Notë krediti kuptojmë – dokument i lëshuar për qëllim të një rregullimi nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve, pasi që të jetë lëshuar fatura tatimore ose një dokument që shërben si faturë, ku shuma e Tvsh-së së ngarkuar në faturën tatimore ose në dokumentin që shërben si faturë, është me i vogël se obligimi real i Tvsh-së për atë furnizim të tatueshëm.

E saktë

E pasaktë

14. Puna provuese sipas Ligji të Punës mund të zgjatë më së shumti tre (3) muaj.

E saktë

E pasaktë

15. Bazuar në ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, mospagesa e detyrimit tatimit në kohën e paraparë me ligjet tatimore, bazuar në Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat do të paguajë një interes prej 0.65% në muaj apo pjesë të muajit.

E saktë

E pasaktë



16. Sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, a)Kompensimi ose pagat e paguara për personin e lidhur si dhe b)Interesi, qiraja dhe shpenzimet tjera që i paguhen personave të lidhur, lejohen si shpenzim i zbritshëm shuma që përcaktohet sipas vullnetit të tyre.

E saktë

E pasaktë

17. Blerjet për të cilat një faturë është lëshuar duhet të futet në librin e blerjeve brenda 15 ditëve pas pranimit të faturës së blerjes. Poashtu, Shitjet për të cilat një faturë e shitjes është lëshuar duhet të futet në librin e shitjeve brenda 15 ditëve pas lëshimit të faturës së shitjes.

E saktë

E pasaktë

18. Sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, çdo tatimpagues që bënë pagesa për personat fizik jo-afarist, bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve recikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to është i obliguar të mbajë tatimin në burim në shkallën prej pesë përqind (5%) të bruto pagesës, në momentin e pagesës.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, shpenzimet e trajnimit të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar, që lidhen me punën, lejohen plotësisht në vitin në të cilin shpenzimet e tilla të trajnimit kanë ndodhur.

E saktë

E pasaktë

20. Kontributi i një aksionari në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar në shkëmbim me një Aksion, mund të bëhet në të holla; pronë tjetër, materiale ose jo-materiale; me punë ose shërbime të ekzekutuara.

E saktë

E pasaktë

## Pjesa C. Pyetjet problemore

### Problemi 1

15 pikë

Kompania GUACA shpk me seli në Gjilan, e regjistruar me Tvsh ka prezantuar informatat në vijim sa i përket aktivitetit të saj afarist për 12 mujorin e vitit të kaluar 2020:

- Avancet e pranuar : 24,000 Euro (saldo me datë 31 dhjetor)
- Export ne Shqipëri : 15,000 Euro
- Importe të rregullta IM4 (mall tregtar) : 60,180 Euro (përfshirë Tvsh 18%)
- Shitjet kesh : 129,900 Euro (përfshirë Tvsh 18%)
- Shitjet me me afat : 64,800 Euro (përfshirë Tvsh 8%)
- Shpenzimet bankare : 4,200 Euro
- Pagat Bruto : 28,800 Euro (përfshirë KP të punëdhënësit)
- Shpenzimet tjera me fature (përfshirë Tvsh 8%) : 3,564 Euro
- Blerjet vendore (mall tregtar) : 34,998.80 Euro (përfshirë Tvsh 18%)
- Import investiv (veturë) : 12,800 Euro (përfshirë Tvsh 18%)
- Shp. e zhvleresimit vjetor : 7,700 Euro
- Stoqet në fillim të vitit : 43,200 Euro ( me kosto)
- Shpenzime familjare nga pronari të paguara me kartelë të biznesit : 2,500 Euro.
- Stoqet në fund te vitit : 50,000 Euro (me çmim të shitjes pa përfshirë Tvsh-në;  
(marzha bruto 45% e ngarkuar)
- Shpenzimet tjera me fature (përfshirë Tvsh 18%) : 14,986 Euro
- Shpenzimet tjera me fature (pa Tvsh ) : 1,686 Euro
- Tërheqjet nga pronari :6,000 Euro (kesh)

Norma e tatimit në fitim është 10%.

**Kërkohe:**

- a) Të përpilohet pasqyra e të ardhurave sipas ligjit TAK ? **12 pikë**  
b) Sa është marzha Bruto dhe Neto mbi shitjet për periudhën e vitit ? **3 pikë**

Zgjidhje:

		Sqarimet:
Shitjet totale (kesh dhe me afat)+Eksportet	185,085	<-- 15,000 <-- ( 129,900)/1.18) <-- ( 64,800)/1.08)
<b>KMSH</b>		
Stoqet në fillim	43,200	
+Blerjet vendore dhe importet e mallit tregtar	80,660	<--- (34,998.80/1.18) <--- (60,180.00/1.18)
-Stoqet në fund	27,500	<--- (50,000x(1-45%))
	<u>(96,360)</u>	
<b>Fitimi Bruto</b>	88,725	
Shpenzimet e pagave	(28,800)	
Shpenzimet e zhvleresimit	(7,700)	
Shpenzime bankare	(4,200)	
Shpenzimet tjera (me TVSH 18%)	(12,700)	<--- ( 14,986.00/1.18)
Shpenzimet tjera (me TVSH 8%)	(3,300)	<--- ( 3,564.00/1.08)
Shpenzimet tjera (pa TVSH )	<u>(1,686)</u>	
<b>Fitimi para tatimit</b>	30,339	
Tatimi @10%	<u>(3,034)</u>	
<b>Fitimi Neto</b>	27,305	
Marzha bruto mbi shitjet: $185,085/88,725= 47.94\%$		
Marzha neto mbi shitjet: $185,085/27,305= 14.75\%$		

Kompania LENOVO shpk me seli në Prizren kryen disa aktivitete ekonomike dhe gjatë muajit Nëntor 2020 ka këto transaksione:

- exporte gjatë Nëntorit në vlerë 15,000 Euro,
- dy(2) importet të rregullta (IM4), mall tregtarë për rishitje, në vlerë 18,800 Euro + shpenzimet e transportit 1,200 Euro (baza doganore e aplikueshme 10%),
- blerjet vendore me normë standarde të këtij muaji kanë qenë në vlerë prej 55,000 Euro, 80% e të cilave kanë qenë blerje e mallit tregtar për rishitje.
- shitjet brenda vendit me norme 18% - shuma e tatueshme 102,000 Euro,
- shitjet brenda vendit me normë të reduktuar 43,200 Euro (përfshirë Tvsh-në),
- shërbime transportit Prishtinë - Shkup 4,000 Euro,
- blerjet nga bizneset të cilat nuk janë të regjistruar në Tvsh 5,000 Euro,
- import nga Austria (veturë) i cili shërben për aktivitetin e biznesit, vlera e faturës me shpenzime përcjellëse 9,090.91 Euro (pasuri që i nënshtrohet doganës 10%),
- blerje e një veture në vlerë të koston prej 50,000 Euro nga një biznes vendor me norme 18% i cili konsiderohet si veturë luksi (vlerësimet fillestare janë që kjo pasuri do të zhfrytëzohet 50% për qëllime biznesi),
- shpenzimet e zhvlerësimit mujor janë llogaritur në vlerë 5,000 Euro,
- notë kreditore e lëshuar me normë 18% vlera e Tvsh-së 2,000 Euro,
- nota debitore e pranuar me normë 8% me vlerë të tatueshme 2,125 Euro,
- shpenzime të rrymes, ujit me vlerë të tatueshme 2,500 Euro,
- pagat Bruto për muajin Nëntor kanë qenë në vlerë prej 6,500 Euro,
- qiraja sipas kontratës LRP 17/2034-489 është në vlerë mujore 1,000 Euro,

Poashtu gjatë këtij muaji ka pranuar shërbime të nga jashtë vendit në vlerë prej 3,000 Euro (ngarkesë e kundërt).

Vlerat e paraqitura janë pa përfshirë Tvsh-në. Biznesi në fjalë ka trashëguar një kreditim të muajit Tetor 2020 në vlerë prej 1,030 Euro.

#### **Kërkesa:**

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së Tvsh-së sipas renditjes se sa ka pagesë/kreditim për muajin 11/2020.

Zgjidhje: Ekstrakt i deklaratës mujore Tetor 2020:

<b>[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH</b>			
Periudha e Deklarimit:	Kolona [ 1 ]	<b>11</b>	<b>2020</b>
Numri Fiskal:	Kolona [ 3 ]	<b>600700800</b>	
Emri i biznesit:	Kolona [ 4 ]	<b>LENOVO shpk</b>	
Adresa e biznesit:	Kolona [ 5 ]	<b>PRIZREN, KOSOVË</b>	
Emri i personit kontaktues dhe telefoni:	Kolona [ 6 ]	<b>Fistek Filani 044/123123</b>	
<b>Furnizimet Vlera</b>			<b>TVSH</b>
Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi	Kolona [ 9 ]	-	
Shitjet e liruara me të drejtë kreditimi	Kolona [10]	<b>4,000</b>	
Eksportet	Kolona [11]	<b>15,000</b>	
Shitjet e tatueshme me normën 18%	Kolona [12]	<b>102,000</b>	<b>18,360</b>
Shitjet e tatueshme me normën 8%	Kolona [14]	<b>40,000</b>	<b>3,200</b>
Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt	Kolona [28]	<b>3,000</b>	<b>540</b>
		<b>Kolona [30]</b>	<b>22,100</b>
<b>Blerjet Vlera</b>			<b>TVSH</b>
Blerjet dhe importet pa TVSH	Kolona [31]	<b>5,000</b>	
Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme	Kolona [34]	<b>29,500</b>	
Importet me normë 18%	Kolona [35]	<b>22,000</b>	<b>3,960</b>
Importet investive me normë 18%	Kolona [39]	<b>10,000</b>	<b>1,800</b>
Blerjet vendore me normë 18%	Kolona [43]	<b>55,000</b>	<b>9,900</b>
Blerjet vendore me normë 8%	Kolona [45]	<b>2,500</b>	<b>200</b>
Blerjet investive vendore me normë 18%	Kolona [47]	<b>25,000</b>	<b>4,500</b>
Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 18%	Kolona [53]	<b>11,111.11</b>	<b>2,000</b>
Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 8%	Kolona [55]	<b>2,125.00</b>	<b>170</b>
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	Kolona [65]	<b>3,000</b>	<b>540</b>
		<b>Kolona [67]</b>	<b>23,070</b>
<b>Kalkulimi Vlera</b>			
Teprica a TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	Kolona [68]	<b>1,030</b>	
Balanca kreditore e mbetur 69 = ((67+68)-30)>0	Kolona [69]	<b>2,000</b>	
Kërkesa për rimbursim	Kolona [70]	-	
Kreditimi i tvsh-së per muajin pasues 71 =(69-70)	Kolona [71]	<b>2,000</b>	
<b>TVSH që duhet të paguhet 72 =(30-67-68)&gt;0</b>	Kolona [72]	-	

Sqarim: Blerjet dhe importet me Tvsh jo të zbritshme :

$(50,000 \times 50\%) = 25,000$  (pjesa e kostos)  
 plus(+)  $50,000 \times 50\% \times 18\% = 4,500$  (pjesa e Tvsh-së së pazbritshme)  
 Total  $= 29,500$

Blerjet investive vendore me normë 18%:  $50,000 \times 50\% = 25,000$   
 Importet investive me normë 18%:  $9,090.91 + 10\% = 10,000$

**Problemi 3****7 pikë**

Kompania AMORTIZATORI shpk e cila kishte filluar aktivitetin disa vite më parë, me datë 31.12.2020 kishte këtë gjendje të aseteve sipas kontabilitetit.

#	Lloji i pasurisë	Përshkrimi i pasurisë	Furnitori	Kosto e blerjes	Vlera me TVSH	Data e Blerjes
1	NDËRTESEË	Lokali në Prishtinë (150m2)	ABC shpk	300,000	354,000	29.09.2015
2	TOKA	Toka në Veternik (22 ari)	Fistek Filani	161,000	161,000	27.11.2017
3	PAJISJE TJERA	Rafte per Depo (1000kg)	RAFTI shpk	8,000	9,440	18.02.2016
4	MJETE TRANSPORTUES	Ford	AUTOMOBILI shpk	7,000	8,260	16.01.2017
5	MJETE TRANSPORTUES	WW CADDY	AS VETURA	6,000	7,080	06.10.2015
6	LICENCE	Licence per DEPO 5 vjeçare	MINISTRIA E SHENDETSISË	5,000	5,000	27.07.2020
7	MJETE TRANSPORTUES	KAMIONI	GERMAN AG	13,000	15,340	27.11.2020
				<b>500,000</b>	<b>560,120</b>	

**Kërkohet:** Të llogaritet zhvlerësimi/ Amortizimi sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave për vitin që përfundon me 31.12.2020 ?

## Zgjidhje:

#	Lloji i pasurisë	Përshkrimi i pasurisë	Kosto e blerjes	Data e Blerjes	Zhvlërimi/Amortizimi për vitin 2020
1	NDËRTESE	Lokali në Prishtinë (150m <sup>2</sup> )	300,000	29.09.2015	=300,000 x 5% = 15,000 euro
2	TOKA	Toka në Veternik (22 ari)	161,000	27.11.2017	nuk zhvlërohet
3	PAJISJE TJERA	Rafte per Depo (1000kg)	8,000	18.02.2016	=8,000 x 20% = 1,600 euro
4	MJETE TRANSPORTUESE	Ford	7,000	16.01.2017	=7,000 x 20% = 1,400 euro
5	MJETE TRANSPORTUESE	WW CADDY	6,000	06.10.2015	=6,000 x 20% = 1,200 euro / 2 = 600 (pjesa e mbetur për 2020) (blerja është bërë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2015)
6	LICENCE	Licence per DEPO 5 vjeçare #010633	5,000	27.07.2020	=5,000 / 5 vite = 1,000 / 2 = 500 euro (amortizim) (blerja është bërë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020)
7	MJETE TRANSPORTUESE	KAMIONI	13,000	27.11.2020	=(13,000 x 20%) / 2 = 1,300 euro (blerja është bërë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020)
			<b>500,000</b>	-	<b>Total për vitin 2020: 20,400 euro</b>

Kompania "STREHA" për vitin 2019 ka pasur një fitim neto 80,000 Euro dhe tatim në të ardhurat e korporatave bazuar në deklaratën përfundimtare në vlerë prej 8,000 Euro. Parapagimi i kësteve ka qenë në shumë prej 55,000 EUR (metoda historike), diferenca prej 5,000 Euro është paguar me deklaratë përfundimtare me 31 mars 2020.

Bazuar në vendimin e menaxhmentit të kompanisë për vitin 2020 parapagimi i tatimit në të ardhurat e korporatave do të vazhdoje të paguhet bazuar në metodën e "strehës së sigurt" edhe pse është planifikuar sipas këtij buxheti se fitimi do të jetë rreth 120,000 Euro.

**Kërkohet:**

Sa do të jetë shuma e një kësti për vitin 2020 për Kompaninë "STREHA".

**Zgjidhje:**

Për periudhen vijuese të vitit 2020, paguhet së paku një e katërta (1/4) e 110% të detyrimit tatimor të përgjithshëm të periudhës paraprake ( në këtë rast të vitit 2019), që rezultoi 8,000 Euro.

Kalkulimi për këstet e vitit 2020:

$8,000 \times 110\% = 8,800 \times \frac{1}{4} = 2,200$  Euro ( pagesa minimale 80% e vlerës 2,200 pa nëshkime).



Pas Kontrollit nga ana e ATK-së tek kompania PAVARSIA sh.p.k. për periudhën 03/2016 për Tvsh rezultojë me obligim shtesë prej 4,500 Euro.

1. Akti i kontrollit u dorëzua tek kompania së bashku me njoftim vlerësimin në Maj 2017.

2. Deklarim dhe Pagesa e Tvsh-së nga kompania për këtë periudhë kishte qenë 22,050 Euro (deklaruar dhe paguar në kohë).

**Kërkohet:**

Sa janë gjordat dhe interesi përkatës që aplikohen tek njoftim vlerësimi për tatimin shtesë të dal nga akti i Kontrollit bazuar në Ligjin mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore?

**Zgjidhje:**

1. Gjorda për nën deklarim tatimor 25% e tatimit shtesë:	$4,500 * 25\% = 1,125.00$
2. Gjorda për mos pagese në kohë 1% në muaj ( max 12 muaj):	$4,500 * 1\% \times 12M = 540.00$
3. Interesi 0.65 % në muaj ( 14 muaj) :	$4,500 * 0.65\% \times 14M = 351.00$
<b>TOTAL</b>	<b>2,016.00</b>

**Problemi 6****8 pikë**

Kompania ENISI Co shpk ka të punësuar dy punëtorë ( një menaxher dhe një agjent i shitjes). Paga e të punësuarve për muajin Janar 2021 janë si me poshtë:

Menaxheri	1000	Paga Neto
Agjenti	750	Paga Bruto

**Kërkoet:**

Llogaritni detyrimin e tatimit në paga dhe kontributin pensional (KP) për muajin Janar 2021 të këtyre të punësuarve (Kujdes pagat janë **neto/bruto**).

**Zgjidhje:****1. Menaxheri: paga Nëntor = 1000 Neto**

	a	b	c=axb	d=a-c	
	Paga e tatueshme	Shkalla Tatimi e tat.	Paga	Neto	Kumulative Paga Neto
1.	80	0%	0	80.00	80.00
2. (1*)	170	4%	6.80	163.20	143.20
3. (2*)	200	8%	16.00	184.00	427.20
4.(3*)	636.44	10%	63.64	572.80 (3*)	1,000.00
<b>TOTAL</b>	<b>1,086.44</b>		<b>86.44</b>	<b>1,000.00</b>	

**KP:**

Paga bruto  $1,086.44/95\% = 1,143.62$

KP =  $1,143.62 \times 5\% = 57.18 + 57.18 = 114.36$

(1\*) diferenca e pages nga 80 - 250 = 170

(2\*) diferenca e pages nga 250 - 450 = 200

(3\*) diferenca e pages neto  $80+163.20 +184= 427.20$

Paga neto e menaxherit  $1000 - 427.20 = 572.80/90\% = 636.44$

2. Agjenti: paga Janar = 750 Bruto

KP =  $750 \times 5\% = 37.50 + 37.50 = 75.00$

(\*)Paga e tatueshme  $750 - 37.50 = 712.50$

	Rangu	% e tatimit	Tatimi
Niveli 1	0 - 80	0%	0.00
Niveli 2	80 - 250	4%	6.80
Niveli 3	250 - 450	8%	16.00
Niveli 4	450 - 712.50 (*)	10%	26.25
TOTAL			49.05

Paga neto:  $712.50 - 49.05 = 663.45$

	Paga Bruto	Tatimi	Pensioni	Pensioni	Paga Neto
Menagjeri	1,143.62	86.44	57.18	57.18	1,000.00
Agjenti	750.00	49.05	37.50	37.50	663.45